

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Shpenzime per D.D.D”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

24455000-8

33631600-8

VLERA E FONDIT LIMIT:

3 500 000(tre milion e pesëqind mijë) leke pa tvsh

Bazuar në nenin 76 pika 3 të VKM 285 datë 19.05.2021 “Rregullat e Prokurimit Publik” e ndryshuar, në zbatim të urdhërit të titullarit, për ngritjen e komisionit për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës për procedurën e prokurimit komisoni pasi u njoh me objektin e prokurimit, bazuar në VKM 285 datë 19.05.2021 neni 76, bazuar studimin e tregut ka bërë përlogaritjen e vlerës limit të kontratës.

Vlera limit është llogaritur sipas mesatares së ofertave të testimit të tregut.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoritet kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapacitetin profesional te Operatoreve Ekonomike

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare 2022, 2023 , 2024, ku Vlera e xhiros minimale vjetore që kërkohet nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës.

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, 2024.

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”.

2.2.3 Vërtetim të shlyerjes së taksave e tarifave vendore për vitin 2025 në të gjitha pikat e ushtrimit të veprimtarisë sipas të dhënave përkatëse të ekstraktit të QKB-së.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024; në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për kontrata të mëparshme të ngjashme, ku vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 Për Prokurimin Publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 20 % të vlerës së fondit limit. Përvoja e mëparshme është një element i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik, për të vërtetuar se mallrat objekt prokurimi plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesi certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë si më poshtë:

- Certificate e sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 ose ekuivalente.
- Certificate ISO 14001 :2015 ose ekuivalente.

Argumentim: Ky kriter është vendosur në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit

Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe nenit 40 dhe nenit 44, të VKM-se Nr.

285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar mallrat objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi

i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetin teknik lidhur me përvojën e duhur, vërtetuar kjo edhe nëpërmjet dokumentave si certifikata ISO e cila është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar suksesin e kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik për produktet Biocide(insekticide, dizifektant, rodenticidet) duhet të disponojë akt autorizimi për përdorimin e produktit Biocid.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Ky kriter bazohet në Ligjin Nr.95.2015; Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik; I cili ka si qëllim mbrojtjen e shëndetit publik nga organizmat e dëmshëm nëpërmjet përdorimit të sigurt të produkteve biocide. Ky ligj përcakton dhe rregullon vendosjen në treg të lëndëve biocide, prodhimin, importin si edhe organizimin dhe funksionimin e kontrollit të organizmave të dëmshëm në shëndetin publik.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga Prodhuesi ose Distributori i autorizuar për mallrat e ofertuara ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar.

Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website, të nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti kontraktor, si përfitues direkt i mallrave objekt prokurimi me anë të këtij kriteri kërkon garantimin se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për mallrat e furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion përkatës. Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Referuar natyrës dhe objektit të prokurimit autoriteti kontraktor ka vendosur këtë kriter në përputhje edhe me Specifikimet Teknike të mallit duke kërkuar cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Ky kriter lidhet gjithashtu me cilësitë e artikujve dhe nevojës për garanci mbi efikasitetin dhe kapacitetet teknike të secilit zë.

2.3.5 Preparatet kimike duhet te jene te pajisura me certificate origjine.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Vendosja e këtij kriteri njeh gjendjen, cilësinë dhe besueshmërinë e mallit. Ky kriter vlereson origjinën dhe informacion për produktin, gjë që ndikon në besueshmërinë e tij.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

SPECIFIKIME TEKNIKE

Preparate dezinfektuese, dezinfektuese dhe deratizuese

- ☐ Preparat për luftimin e insekteve fluturuese dhe zvarritëse për ambiente të jashtme e të brendshme të tipit Cypermethrin 8-10% ose në përqindje ekuivalente me të njëjtin efekt, me ngarkesë toksiciteti jo më të madhe se i parashikuar për këtë produkt.
- ☐ Preparat piretroid për luftimin e insekteve fluturuese dhe zvarritëse për ambiente të jashtme të tipit: (Deltamethrin 2%) ose në përqindje ekuivalente me të njëjtin efekt, me ngarkesë toksiciteti jo më të madhe se i parashikuar për këtë produkt.
- ☐ Rodenticid me antikoagulantë të gjeneratës së I-rë (Coumatetralyl) ose ekuivalente
- ☐ Insekticid Adulticid neuro-nikotinoide (Thiamethoxan) ose ekuivalente.
- ☐ Preparat për luftimin e mizave dhe mushkonjave për ambiente të brendshme me permbajtje: (Deltamethrin 2.5%) ose në përqindje ekuivalente me të njëjtin efekt, me ngarkesë toksiciteti jo më të madhe se i parashikuar për këtë produkt.
- ☐ Insekticid neuro-nikotinoide (imidacloprid xhel) ose ekuivalente
- ☐ Repelent për zvarranikët squfur i paketuar
- ☐ Dezinfektant me lënda aktive amon kuaternar, glutaaraldehid, dhe isopropanol (0.5-1%) ose ekuivalente me të njëjtin efekt, me ngarkesë toksiciteti jo më të madhe se i parashikuar për këtë produkt.

Mjete dhe pajisje për shërbimin DDD

- ☐ Pompë sperkatje shpine me bateri 20 litër, 12 V, 12 Ah.
- ☐ Doreza latex ose nitrile jo sterile me ose pa pudër të bardha në masat L, në kuti kartoni minimalisht 100 copë

- ☐ Syze pune të jenë transparente me gomine. Te ndertuara nga plastike e cilesise se larte, me rezistence maksimale duke siguruar mbrojtjen e syve dhe pjeseve jetesore rreth syrit.
- ☐ Mbulesë këpuce, e cila të jetë njëpërdorimshe, PE, elastike për të mundësuar përshtatjen e saj në madhësi të ndryshme dhe e sigurt në ambiente sterile.
- ☐ Stekë spërkatëse me gjatësi 30 cm
- ☐ Doreza pune ndaj agjentëve kimik material nitrile dhe shtresë të brendshme pambuku
- ☐ Maska kundragaz me filtër gazi
- ☐ Kominoshe të bardha 1 përdorimshe masa XL, të cilat përdoren në ambiente sterile. Produkti të sigurojë mbrojtje për rrobat dhe trupin nga faktorë të ngurtë apo të lëngshëm.
- ☐ Maskë mbrojtëse 1 përdorimshe në kuti kartoni
- ☐ Çizme të gjata poliestër masa XL, me densitet të lartë dhe elastik në të njejtën kohë, deri në kraharor, që të mund të përdoren për të kaluar vende ku lartësia e ujit është e madhe.

Argumentimi i specifikimeve teknike: Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistët e fushës, pjesë e DST.

Specifikimet teknike, për procedurën objekt prokurimi, shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e mallit dhe lidhen ngushtë me natyrën e kontratës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo specifikim dhe standard të kërkuar.**

NJESIA E PROKURIMIT

Senada Ndini

Ing. Eduard Hila

Teuta Dano